

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo Zyra e Kryeministrit - Ura e Primitjeve - Office of the Prime Minister SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nr. Dreg. Cilësor 01	Nr. Dreg. Dreg. Dreg. Dreg. Nr. 1059
Nr. Fjalor 27 fjalor 80 fjalor - PZ -	Data: Duhet: Date: 05 / 04 / 2018
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministry of Finance

Për : Kryeministrin e Republikës së Kosovës,

z. Ramush Haradinaj

Nga : Zëvendësministri i Financave

z. Mustafa Grainca

Lënda : Raporti i punë

I nderuari z. Kryeministër Haradinaj,

Bashkangjitur me këtë shkresë kemi raportin e punës tre mujore, i cili përmban aktivitetet e zhvilluara pranë Ministrisë së Financave.

Datë, 03.04.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Raport pune

Mustafa Grainca

Zëvendësministër i Financave.


A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Mustafa Grainca', written over a horizontal line.

Datë, 10.04.2018,

Hyrje

Mbështetur në kërkesën e Kryeministrit të Kosovës z. Ramush Haradinaj, në mbledhjen e mbajtur datë 28.12.2017, unë z, Mustafa Grainca , zëvendësministër i Financave, dorëzoj këtë *raport pune*, i cili pasqyron aktivitetet e zhvilluara pranë Ministrisë së Financave si dhe Komunës së Ferizajt.

Emrimi im si zëvendësministër i Financave (*data e emërimit 10.10.2017*), dhe më pas, këshilltar dhe koordinator i zhvillimit ekonomik pran komunës së Ferizajt (*data e emërimit 19.01.2018*), është marrje e obligimit institucional, për të ushtruar me përgjegjësi e profesionalizëm këto funksione publike , në funksion të rritjes së efikasitetit, duke shtuar aktivitetet në kuadër të tyre .



Raporti i punës, përshkruan aktivitetet të cilat janë zhvilluar mbrenda kësaj periudhe raportuese, e të cilat besoj se kanë ndikuar në ngritjen e nivelit të performancës së Ministrisë si dhe asaj të komunës së Ferizajt, në aspekti të zhvillimit ekonomik.

Gjatë kësaj kohe, kam zhvilluar një mori aktivitete në cilësinë e zëvendësministrit si dhe të këshilltarit dhe koordinatorit, për zhvillim ekonomik, komuna e Ferizajt, të cilat do të përshkruaj në mënyrë të detajizuar, duke nxjerrur edhe konstatimet mbi pritjet e rezultateve.

Ministria e Financave, është njëra ndër digasteret më rendësi të veçant pranë Qeverisë së Republikës së Kosovës, rezultatet e shënuara nga menaxhmenti i saj, do të kenë ndikim në zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit tone, andaj rritja e aktiviteteve në kuadër të përgjegjësisë institucionale, është nevojë dhe kërkesë imediate, për të shtuar edhe më shumë, rezultatet në të dy institucionet e nivelit qeverisës.


REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA IRODJEVAL • MUNICIPALITY OF FERIZAJT


ZYRA E KRYETARIT KRYETARIT
 URBED-KABINELE I KRADINACI I NIRA
 OFFICE OF MAYOR
 01800
 Data: 19/04/2018

Telefoni: 038/299-4600
 e-mail: shkolosori@koshqerje.com
 faxes: info.ferizaj@koshqerje.com

Në bazë të nenit 13 dhe 38, paragrafi 12 Ligjit për Veprimet e Lokale Nr.03/L-40 (Uazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 2 të U. Dekretit Administrativ të MAPI Nr.02/2014 për Çaktimin e Stafit Mbrojtës në Komunë, nenin 66, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Ferizajt, si dhe vendimin e kryetarit për "Formimin e Këshillit mbledhëor" pikë III e këtij vendimi, me datën 10.01.2018, kryetar i Komunës:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E KËSHILLTAR-KOORDINATOR PËR ZHVILLIM EKONOMIK

I. Z. Mustafa Grinares, emërohet Këshilltar-Koordinator për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Ferizajt prej datës 19/04/2018 deri në përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës.

II. Harq Semendari, punën e kryer profesionale do të kompensohet nga paga e zëvendësministrit.

Arsyetimi

Mësondhet në misionin institucional të të dy niveleve qeverisëse dhe nga detyrat e detyra nga kryeministri i Republikës së Kosovës për mbledhjet e Komunave, në aspektin e zhvillimit ekonomik, Kryetari i Komunës, emëron Z. Mustafa Grinaca, Këshilltar-Koordinator të Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Ferizajt, duke parasysh në 180 rasti, nevojën e mbledhësve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për aspektin buxhetor edhe të këshilltarsive për lufat e postshkëmbimtare.

- Këshillton kryetarin e Komunës dhe statin në fushën e zhvillimit ekonomik të Komunës;
- Këshillton kryetarin në sferën e menaxhimit të financave publike;
- Koordinon proceset të cilat lidhen me zhvillimin ekonomik;
- Duke qenë i autorizuar nga kryetari i Komunës ushtron detyrën e koordinatorit të këshillit mbledhëor;
- Koordinon proceset zhvillimore në mes dy niveleve qeverisëse (qendrore dhe lokale);
- Këshillton kryetarin në implementimin e projekteve kapitale të cilat janë të lidhura drejkt me zhvillimin ekonomik;
- Këshillton kryetarin dhe koordinon aktivitetet për projektet të cilat financohen nga donatorët.

Obligohet të raportojë para Kryetarit të Komunës për proceset e zhvillimit ekonomik.

Të dërgohet:
 - Z. Mustafa Grinaca
 - Zyres së Kryetarit
 - Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme
 - Njësitë së Personelit për dosje


 Kryetari i Komunës
 Harq Semendari

Përmbajtja e raportit

a) Aktivitetet e zhvilluara pranë Ministrisë së Financave

- Mbledhja e këshillit ministror për shqyrtimin e raportit të performacës së ndërmarrjet publike;
- Takim pune me Drejtorin e ATK-së;
- Takim pune në Këshillin Ekonomik Social;
- Takimi pune Investitorët nga Emiratet e Bashkuara;
- Takim me investitor Italian, lidhur me mundësin e investimeve në zhvillimin e projekteve në fushën e Turizmit,
- Takime pune me drejtor të departamentesh:
 - Departamenti tatimin në pronë*
 - Departamenti i politikave fiskale dhe tregjeve financiare*
 - Departamenti i buxhetit*
 - Departamenti i thesarit*
 - Departamenti qendror për Partneriet Publiko Privat*
- Takim me drejtorin e ATK/së, në regjionin e Ferizajt;
- Takim me *Presidentin e Auditorit të përgjithshëm të Polonisë*;
- Takim pune me *Ministrin e Tregëtisë dhe Industrisë* lidhur me krijimin e zonës ekonomike Ferizaj.
- Takim pune me *Odën Afariste e Kosovës*;
- Takim me përfaqësues të bizneseve / Ferizaj, lidhur me aplikimin e vendimit të Qeverisë mbi masat lehtësuese 2.0;
- Takim pune me zëvendësministrin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.
- Ligjerat para studentëve të Kolegjit Universum


b) Aktivitetet e zhvilluara si këshilltar dhe koordinator i zhvillimit ekonomik Komuna Ferizaj

- Takim me stafin politik të kryetarit të Komunës së Ferizajt
- Koordinimi i aktiviteteve të Këshillit ndërdrejtorial për zhvillim ekonomik
- Takim në cilësin e zëvendësministrit dhe koordinatorit me përfaqësuesit e GIZI-t Gjerman
- Takim pune me përfaqësuesen e Bankës Botrore;

- Takim pune me përfaqsesit e kompanisë Tconsalting, lidhur me mundësin e përfitimit të granteve / fondacioni IPA 2018;
- Takim pune , së bashku me Kryetarin e Ferizajt z, Aliu, me Ministrin e infrastrukturës z.Pal Lekaj,
- Takim pune , së bashku me Kryetarin e Ferizajt z, Aliu, me Ministrin e Inovacionit z.Besim Beqaj
- Takim pune me përfaqsesit e Caritas Kosova;
- Takim pune , përfaqsesit e departamentit të PPP.

Mbledhja e këshillit ministror për shqyrtimin e raportit të performacës së ndërmarrjet publike;

Mbështetur në përcaktimin e detyrës nga ana e ministrit z. Bedri Hamza, mora pjesë në mbledhjen e komisionit ministror për Ndërmarrjet Publike, në të cilën u diskutua raporti i performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe 2016. Në këtë takim u diskutua raporti i performancës së ndërmarrjeve publike 2105/16, ku një zëri u kritikua niveli i performancës së treguar të këtyre ndërmarrjeve, pasi që shumica prej tyre përmbyllen vitet raportuese më humbje financiare, gjithashtu edhe me opinione jo të kënaqshme nga auditori i jashtëm. Komisioni ministror miratoj këto raporte me vërejte, duke dhënë rekomandime konkrete për avancimin e politikave menaxhuese, në funksion të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të ndërmarrjeve publike.



***Konstatim:** Njëzëri u konstatua se gjendja e përgjithshme në ndërmarrjet publike është alarmante, me përjashtim të disave, dhe se lypset angazhim i shpejt e produktiv institucional për të ndaluar këtë degradim të këtyre ndërmarrjeve.*

Takim pune në Këshillin Ekonomik Social;

Mbështetur në përcaktimin e detyrës nga ana e ministrit z. Bedri Hamza, mora pjesë në mbledhjen e Këshillit Ekonomik Social të Kosovës, (KES), i cili kishte karakter konstituiv, në ç'rast u prezantuan anëtarët e rinj të Këshillit. Gjithashtu në këtë takim me theks të veçantë u diskutua edhe rreth funksionalizimit të komisioneve profesionale të KES-it, si dhe u diskutua për, *Projekt udhëzimin Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.09/2013*, u diskutua gjithashtu edhe për kriteret dhe procedurat e përcaktimit të pagës minimale në Kosovë. Bashkërisht, të gjithë anëtarët e KES janë pajtuar për bashkëpunim dhe angazhim reciprok për të zhvilluar dialogun social edhe më tutje në nivel bipartit ashtu edhe në nivel trepartit, si dhe është dakorduar që çështjet kryesore të punës të Këshillit të trajtohen me prioritet.



***Konstatim:** U dakordua që në mbledhjen e radhës së KES- së, të përcaktohet edhe limiti i ri i pagës minimale në Kosovë, si një domodashmëri , por gjithnjë në përputhje me ligjet në fuqi.*

Takim pune me Drejtorin e ATK-së;


Në këtë takim pune , me drejtorin e ATK-së, diskutuam mbi ecurinë e inkasimit të të hyrave, për realizimin e planit vjetor, gjithashtu për procesit të fiskalizimit, si dhe për shumë çeshtje tjera të cilat janë të lidhurave me agjensionin.



Konstatim: Ngritja e performancës së Administratës Tatimore të Kosovës, është domosdoshmëri, dhe për këtë kërkohet angazhim si dhe projeksione të reja menaxheriale , gjithnjë në funksion të arritjes së planifikimeve institucionale.

Takim me Presidentin e Auditorit të përgjithshëm të Polonisë;

Në vazhdim të takimeve, zhvillova takim me Auditorin e përgjithshëm të Polonisë, z. *Krzysztof Kwiatowski*, në të cilin, takim u bisedua rreth projektit të binjakzimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës dhe të Polonisë, I cilësuar si një projekt i rëndësishëm në avancimin e politikave të auditimit në vendin tonë. Falënderova presidentin e auditimit të Polonisë, në emër të Ministrit Hamza, për gatishmërinë e shfaqur për të ndihmuar avancimin e mëtejshëm të performancës të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kosovë, në të njëjtën kohë, shfaqta gatishmërinë e Ministrisë së Financave, për të qenë përkrahë gjitha proceseve në funksion të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.



Konstatim: Implementimi i projektit të binjakzimit të dy institucioneve audituese të të dy vendeve, shihet si një mundësi e mirë për ngritjen e performancës së zyrës kombëtare të Auditimit, në funksion të avancimit të procesit në fushën e menaxhimit të financave publike.

Takim me drejtorin e ATK/së, në regjionin e Ferizajt;

Në vazhdim të takimeve takova Drejtorin regional të Administratës tatimore , Ferizaj, nga i cili u njoftova për sfidat dhe për të arriturat e regjionit të ATK-së këtu në Ferizaj. I regjistruam gjithë ato që janë arritur gjatë kësaj kohe dhe mendoj se ka vende për një përmirësim në performancën, në realizimin e të hyrave. Biseduam dhe që të dy erdhëm në një definim që duhet të pasurohet edhe më tej aktiviteti në mes tatimpaguesve dhe institucionit të ATK-së, e gjithë kjo në funksion të rritjes së të hyrave buxhetore.



Konstatim: Administrata Tatimore e Kosovës, regjioni Ferizaj, edhe pse ka një realizim të mire të planit vjetor të të hyrave, mbetet ende shumë për të bërë në ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të saj.

Takimi pune me Investitorët nga Emiratet e Bashkuara;

E cilësoj si një takim të frytshëm, takimin me menaxherin e kompanisë “PIVOT” z. *Shoaib Walajahi* nga Emiratet e Bashkuara, i cili shfaqti interesimin për investim milionësh në fushën e prodhimit të energjisë. E njoftova investitorin në lidhje me politikat fiskale të aplikuara në Republikën e Kosovës, për lehtësirat që i afron shteti ynë karshi investimeve të huaja. Në anën tjetër menaxheri i kompanisë në fjalë z. *Walajahi* u nda i kënaqur me të dhënat e afuara. Po ashtu të dyja palët u zotuan për vazhdimin e bashkëpunimit në aspektin investimor, edhe në nivel lokal respektivisht në komunën e Ferizajt duke përfshirë edhe fushat e tjera me interes.



Konstatim: Kompanija PIVOT, sipas informatave, ka filluar me investime në fushën e prodhimit të energjisë, duke bashkëpunuar dhe investuar së bashku me partner vendor, ku vlera investimore pritet të jetë rreth 50 milion euro.

Takim pune me Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë lidhur me krijimin e zones ekonomike Ferizaj.


Së bashku me Kryetarin e Komunës së Ferizajt z. *Agim Aliu*, takuam Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, *Z. Bajram Hasani* me bashkëpunëtor, u diskutua për shumë çështje me rëndësi, të cilat ndërlidhen me zhvillimin ekonomik të komunës së Ferizajt, por e veqanta, si temë ishte intensifikimi i aktiviteteve të të dy niveleve për krijimin e zonës ekonomike në komunën e Ferizajt. Ministri Hasani, u zotua se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, do të përkrahë fuqishëm iniciativën e kryetarit Aliu, duke gjetur mundësinë e financimit të projektit për ngritjen e infrastrukturës në zonën ekonomike e cila do të krijohet së shpejti.



Konstatim: U dakordua që së shpejti të fillohet me aktivitetet institucionale për krijimin e zonës ekonomike në Ferizaj, ku financimi i projektit për ngritjen e infrastrukturës, në këtë zonë që synohet të krijohet do të bëhet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Ligjeratë pra studentëve të kolegjit Universum , lidhur me politikat makroekonomike si dhe sfidat e bërjes biznes në Kosovë.

Në ligjeratën e mbajtur në kolegjin Universum, para studentëve të këtij kolegji, trajtova temën "Politikat makroekonomike në zbatim nga qeveria jonë si dhe sfidat e të bërit biznes". Në tërësi studentët i njoftova për politikat makro që zbaton sot qeveria e Republikës së Kosovës, në zberthim lidhur me: *stabilitet makrofiskal, zbatimin e rregullës fiskale, për rritjen ekonomike , për bilancin tregtar, për buxhetin e vitit 2018 si dhe vlersimet e hershme buxhetore, për politikat fiskale, lehtësirat e të bërit biznes, fiskalizimin si proces, luftimi informalitetit ekonomik etj.*



Konstatim: Studentët ishin kureshtar të kuptojnë lidhur me temën e trajtuar, u zhvillua edhe një debat nga i cili u vërtetua se ata vlersojnë të arriturat e institucioneve tona, por se kërkojnë që edhe më tepër të ketë avansim të politikave të përgjithshme ekonomike , në mënyrë që të arrijmë në stadin e dëshiruar të zhvillimit ekonomik , i cili do të gjeneronte vende pune si dhe ngritje të mirëqenies qytetare.

Takim me Kryetarin e Odës Afariste të Kosovës z. Skender Krasniqi

Me kryetarin e Odës Afariste të Kosovës z. Skender Krasniqi , biseduam lidhur me sfidat nëpër të cilat po kalon biznesi kosovar, për mundësin e koordinimit të aktiviteteve për të hartuar politika më të favorshme ekonomike në veqanti të atyre fiskale, duke draftuar dhe miratuar ligjet të cilat rregullojnë jetën afariste në Kosovë. Ministria e Financave , gjithnjë është e gatshme të ndërmar veprimet e duhara në funksion të avansimit të politikave fiskale në favor të të bërit biznes, shembull, marrja e vendimit si dhe fillimi i zbatimit mbi masat e reja fiskale 2.0, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me heqjen e tatimit doganor për lëndën e parë , etj.



ODA E AFARIZMIT TË KOSOVËS
CHAMBER OF DOING BUSINESS IN KOSOVO

Takim me investitor Italian, lidhur me mundësin e investimeve në zhvillimin e projekteve në fushën e Turizmit,

Në vazhden e takimeve , jam takuar me investitor Italian , të përfaqësuar nga z. Mauri Gioti, të interesuar që të bartin kapitalin e tyre në Kosovë, kryesisht për të investuar në projekte të cilat kanë të bëjnë me Turizmin. Unë i njoftova investitorët për mundësitë që afrojnë shteti ynë për investitorët e huaj, për politikat fiskale, si dhe lehtësirat që ofrojnë të dy nivelet qeverisëse.

U dakordua që së shpejti të zhvillohet edhe një takim tjetër , në kuadër të Ministrisë së Financave , për të filluar konkretisht zhvillimin e aktiviteteve të cilat do të gjeneronin në arritjen e mundësisë së investimit në komunën e Ferizajt.

Takim me Kryetarin e Komunës së Ferizajt z. Agim Aliu

Me kryetarin Aliu , biseduam lidhur me mundësinë e rritjes së buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, nëpërmjet financimit shtesë për projektet e vitit 2017, të cilat kanë mungesë të mjeteve financiare, dhe në të njëjtën kohë të zvoglohet masa buxhetore si obligim, i trashëguar nga qeveria e kaluar. U daktrduam që të vazhdohet me komunikimin institucional në mes Komunës së Ferizajt dhe ministris së Financave . për të gjetur mundësinë e financimit e projekteve kapitale të cilat ngrisin mirqenien e qytetarëve të komunës së Ferizajt. Në fund Kryetari Aliu, nëpërmjet zëvendësministrit Grainca, falenderoj Ministrin Bedri Hamza, për përkrahjen e dhënë, Komunës së Ferizajt, duke gjetur mundësinë e futjes në buxhetin e vitit 2018, të projekteve të rëndësishme infrastrukturore, e të cilat kalojnë vlerat milionëshe.



Konstatim: *Thellimi i interaksionit në mes dy niveleve qeverisëse, është domosdoshmëri i kohës, pasi që nëpërmjet këtij veprimi arrijmë të adresojmë nevojat institucionale në kohën dhe vendin e duhur.*

Themelohet këshilli ndërdretorial për zhvillim ekonomik në komunën e Ferizajt

Kryetari i Komunës z. Agim Aliu , themelon këshillin ndërdretorial për zhvillim ekonomik i përbërë drejtorët e këtyre pesë drejtorive komunale: Drejtoria e Financave, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë , Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit, Drejtoria e Infrastrukturës, ndërkaq koordinator i këtij këshilli është caktuar zv.ministri i Financave, njëherit Këshilltari i Kryetarit të Komunës për Zhvillim Ekonomik, Mustafa Grainca.




Konstatim: Themelimi i këshillit ndërdretorial, konsiderohet një hap i qëlluar i Kryetarit Aliu, drejt realizimit të synimeve institucionale në sferën e zhvillimit ekonomik të Komunës së Ferizajt.

Takim i parë me këshillin ndërdrejtorial për zhvillim ekonomik -Komuna Ferizaj

Pas pranimit të detyrës së re atë të këshilltarit dhe koordinorit për zhvillim ekonomik në Komunën e Ferizajt, kam filluar zhvillimin e aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë arritjen e objektivave të përcaktuara nga qeveria e komunës së Ferizajt, në fushën e zhvillimit ekonomik.

Në vazhden e aktiviteteve institucionale të kryetarit Aliu, mori vendimin për themelimin e këshillit ndërdrejtorial për zhvillim ekonomik, ku koordinator të këtij këshilli më cakton mua, duke më shtuar kështu përgjegjësinë institucionale në këtë fushë të rëndësishme.

Në takimin e parë të këshillit miratua planin e veprimit duke rënditur aktivitetet të cilat do të zhvillohen gjatë vitit 2018, në funksion të arritjes së objektivave zhvillimore, si dhe u morë vendimi për hapjen e zyrës për zhvillim ekonomik.




Konstatim: Gjatë këtij viti në komunën e Ferizajt pritet të formohet fondi i punësimit. Ky fond ka synim që krahas zhvillimit të potencialeve ekonomike të rrisë edhe mundësinë e punësimit, e cila pritet të bëhet në pjesën e dytë të vitit 2018, ndërsa pas hartimit të planit të veprimit, shumë shpejt pritet të themelohet edhe zyra e zhvillimit ekonomik me qëllim të krijimit të infrastrukturës lehtësuese në funksion të avansimit të shërbimeve për ndërmarrësin ferizajase e investitor të huaj.

Takim i dytë me këshillin ndërdrejtorial për zhvillim ekonomik -Komuna Ferizaj

Në mbledhjen e radhës e Këshillit ndërdrejtorial për zhvillimin ekonomik, e kryesuar nga koordinatori Mustafa Grainca, u diskutua gjerësisht për projektet më të cilat do të aplikohet në fonde të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, pasi që tani më janë listuar projektet e mundshme me të cilat do të aplikohet në këto fonde , mbështetur në prioritet e përcaktuara.

Në këtë rast u diskutua dhe u mor vendimi për aplikim në fondet e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, me projektin "Digjitalizimin e shërbimeve komunale si dhe digjitalizimin e profilit të komunës së Ferizajt.



Konstatim: Projekti "Digjitalizimin e shërbimeve komunale si dhe digjitalizimin e profilit të komunës së Ferizajt", konsiderohet si një projekt tejet i nevojshëm për ofrimin e shërbimeve efikase qytetarëve dhe bizneseve ferizajase, gjithashtu digjitalizimi i profilit të Komunës , i munguar deri tani, ofron mundësinë e njohjes së potencialeve zhvillimore që ka komuna e Ferizajt përfshirë të gjitha resurset e saja.

Takim me Drejtorin e departamentit të Partneritetin Publiko Privat


Së bashku me Kryetarin e Komunës z. Aliu, takuam z. Ilir Rama drejtor i departamentit të PPP, pranë Ministrisë së Financave. Biseduam lidhur me mundësinë e fillimit të realizimit të projekteve tani më të identifikuara nëpërmjet ligjit të PPP, dhe u dakordua që të dy institucionet në ditët e muajt të vazhdim të intensifikojnë aktivitetet e ndërsjellura për arritjen e këtyre objektivave të përcaktuara nga Kryetari Aliu.



Konstatim: Realizimi i projekteve kapitale infrastrukturore, nëpërmjet ligjit të PPP, është mëse i domosdoshëm për komunat e Republikës së Kosovës, andaj lypset një angazhim edhe më i madh i të gjithë akterve institucional që të shtyejnë para proceset implementuese të kësaj natyre.

Takim në cilësinë e zëvendësministrit dhe koordinatorit me përfaqësuesit e GIZ-it Gjerman

Së bashku me Kryetarin Aliu takuam përfaqësuesit e Gizi-t Gjerman , në të cilin takim u bisudua rreth thellimit të bashkëpunimit në mes institucioneve, por në të njëjtën kohë u bë e ditur se Komuna e Ferizajt është e gatshme të realizoj projekte zhvillimore në bashkëpunim me GIZ-in gjerman. Në këtë takim janë diskutuar një mori çështjesh, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me implementimin e projekteve të përbashkëta që do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik, si dhe arsimin profesional, përkatësisht punësimin e të rinjve.



***Konstatim:** Komuna e Ferizajt tashmë i ka projektet e identifikuar për të ndërtuar raporte bashkëpunimi me GIZ- gjerman, në funksion të realizimit të tyre .*

Takim me ministrin e Inovacionit z. Besim Beqaj

Së bashku me Kryetarin Agim Aliu si dhe stafin e tij, pritëm në takim Ministrin e Inovacionit z. Besim Beqaj, me të cilin diskutuam shumë çështje me rëndësi të cilat kanë në fokus zhvillimin ekonomik të komunës sonë. E veçanta e këtij takimi ishte koordinimi i aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me realizimin e projektit “Krijimi i parkut teknologjik dhe të Inovacionit” në komunën tonë, i cili do të financohet nga ana e Ministrisë së Inovacionit.



***Konstatim:** Komuna e Ferizajt po realizon njërin ndër projektet e veçanta të listuara në projektet me prioritet të qeverisë lokale, “Krijimi i Parkut Teknologjik dhe i Inovacionit”, i cili padyshim se do të jetë një institucion mbështetës dhe motivues për rritjen dhe zhvillimin e bizneseve ferizajase.*